



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 6, Datë 30.07.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani | Kryetar |
| - Z. Bashkim Sykja | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtar |
| - Znj. Ledina Mandia | Anëtar |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2010, mori në shqyrtim praktiken e përsëritur në lidhje me mosperfshirjen e TVSH në çmimet e ofrimit të shërbimeve nga operatori Albtelekom sh.a – për rastin e tarifave të shërbimit ADSL, Aneks i kontratës përkatëse.

Komisioni pas shqyrtimit të çështjes dhe degjimit të perfaqesuesve të Albtelekom sh.a,

VËREN SE:

Kjo praktike, referuar nenit 15, është një praktikë e padrejtë tregtare:

pika 1, sipas të cilit “*Një praktikë tregtare është çorientuese kur, duke konsideruar të gjitha tiparet dhe rrethanat e saj, si dhe kufizimet e mjeteve të komunikimit, jep të mangët informacionin, që i nevojitet konsumatorit mesatar për të qenë i informuar për të marrë një vendim dhe, në këtë mënyrë, e bën apo ka mundësi ta bëjë konsumatorin mesatar të marrë një vendim, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marrë*”.

pika 4, paragrafi c, si praktikë çorientuese, sipas të cilit “*Në rastin e një ftese për blerje, nëse kjo nuk është e qartë nga konteksti, do të konsiderohet si thelbësor informacioni i mëposhtëm:*

çmimi, që përfshin edhe taksat, ose mënyrën në të cilën llogaritet çmimi, kur natyra e mallit ose shërbimit është e tillë që nuk mundëson llogaritjen e arsyeshme paraprake të çmimit dhe, sipas rastit, të gjitha shpenzimet shtesë për transportimin, dorëzimin apo shpenzimet postare ose faktin e pagimit të shpenzime të tilla suplementare, kur ato nuk mund të llogariten arsyeshëm paraprakisht”;

Kjo është praktikë e përsëritur nga ana e Albtelekom sh.a, në vijim të publicitetit “Flisni pafundesisht me të gjithë numrat Albtelekom, vetëm me 500 leke në muaj”,

ndaj te cilit Komisioni i Mbrojtjes se Konsumatoreve ka marre Vendimin nr. 3, date 1.04.2010.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenin 15, pikat 1 dhe 4 (c), si dhe nenin 55 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6/b, dhe c të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008

VENDOSI:

1. Altelekom sh.a te ndaloje shkeljen dhe te marre masa te menjehershme per rregullimin e çmimeve per gjitha shërbimet e ofruara, ne përputhje me dispozitat perkatese te parashikuara ne Ligjin “Per mbrojtjen e konsumatoreve”
2. Te gjobise Altelekom sh.a me 70000 (shtatëdhjetëmijë) lek, për kundërvajtjen administrative, si rrjedhojë e shkeljes së dispozitës të nenit 15 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

KRYETAR I KOMISIONIT

ANILA JANI